

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Albert Zogaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike- kontestimore të paditësit S.S. nga Fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës, të cilin e përfaqëson N.M. avokat nga Prishtina Rr.“..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigma” me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1610/2012 të dt.08.09.2016 në seancën e kolegjit e mbajtur më dt.25.07.2018 mori këtë

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigma” me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1610/2012 i dt.08.09.2016, VËRTETOHET.

Aktgjykimi në pjesën refuzuese, mbetet i pa shqyrtuar.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në par. I të dispozitivit, Miratohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit, S.S., nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës, si e bazuar dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigma”, me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material paditësit të lartpërmendur, për lëndimet trupore t’ia kompensoj shumën prej 2.700.00 €, (dymijë e shtatëqind euro), me kamatën përkatëse ligjore të cilën e paguajnë Bankat komerciale në Kosovë, për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedhë nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, deri në pagimin definitiv, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit, dhe atë për këto kritere të dëmit:

Në emër të dëmit jo material:

- për dhimbje fizike për të gjitha llojet shumën prej 1.500.00€
- për shkak të frikës së përjetuar shumën prej 1.000.00€

Në emër të dëmit material:

- për ushqimin e përforcuar shumën prej 100.00€
- për kujdesin e personit të tretë shumën prej 100.00€

Në paragrafin II. të dispozitivit, Detyrohet e paditura që në emër të dëmit të shkaktuar në automjetin e markës “Volvo”, me targa .... paditësit, t’ia paguaj shumën prej 831.00 €, me kamatë ligjore nga dita e parashtrimit të padisë, deri në pagesën e saj, si dhe në emër të shpenzimeve procedurale, paditësit të ia paguaj shumën prej 924.00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit. Në paragrafin III. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit përtej shumës së gjykuar për kompensimin e dëmit jo material dhe atë për: për shkak të dhimbjeve fizike shumën prej 1.500.00 €, për shkak të frikës së përjetuar shumën prej 1.500.00 €, në emër të dëmit material: për ushqim të përforcuar 200.00 €, për kujdesin e huaj shumën prej 50.00 €, për rehabilitim klimaterik shumën prej 350.00 €, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqit ankesë e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si dhe vendimit mbi shpenzimet e procedurës, me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ashtu që të gjykohen vlera më të ulëta të kompensimit për lëndime trupore shumën prej 800,00 €, ndërsa për dëm material me automjet shumën prej 600,00 €, ose aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK, gjeti se:

**Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkesat e lëndës rrjedhë se: paditësi në padi dhe në precizimin e kërkesë padisë, ka theksua se me datën 19.02.2008, në rrugën magjistrale Prishtinë-Pejë, te Ura e Dobrevës, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit në të cilin lëndime trupore ka pësuar paditësi dhe dëme materiale në automjetin e tij. Po ashtu, edhe i autorizuari i paditësit, ka deklaruar se ekziston baza juridike për kompensimin e dëmit që duhet t’ia paguaj e paditura, nga se shkaktar i aksidentit është drejtues i automjetit i cili ka qenë i siguruar te e paditura. Me parashtrësën e datës 22.06.2016, i autorizuari i paditësit e ka bërë edhe precizimin e kërkesëpadisë. Në anën tjetër i autorizuari i të paditurës në fjalën e tij përfundimtare e nuk e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit sa i përket bazës, por të njëjtën e ka kundërshtuar sa i përket lartësisë, si dhe për kompensimin e dëmit material dhe jo material për lëndime trupore të paditësit, si dhe dëmin material në automjetin e dëmtuar në këtë aksident.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat dhe vlerësuar ato dhe ka vërtetuar gjendjen faktike se me datën 19.02.2012, në rrugën magjistrale Prishtinë-Pejë, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ku si pasojë e këtij aksidenti lëndime trupore ka pësuar drejtuesi i automjetit Volvo me targa .... si dhe dëme materiale në automjetin e tij.

Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë bazuar në raportin e QKUK-së të datës 19.02.2012, ka vërtetuar faktin se paditësi si pasojë e lëndimeve të marra në këtë aksident ka pësuar dëme jo materiale dhe materiale. Për të vërtetuar lartësinë e dëmit në këtë aksident gjykata ka caktuar ekspertizat mjeko-ligjore të cilat i kanë hartuar Dr. S.D. - ortoped traumatolog dhe Dr. M.K. psikiatër dhe ate duke u bazuar në kriteret dhe përmasat të cilat i aplikojnë Kompanitë e Sigurimeve të licencuara në Kosovë dhe praktika gjyqësore.

Sipas ekspertëve mjekësor, rezulton konstatimi se natyra e lëndimeve trupore të paditësit është cilësuar si lëndime të lehta trupore, në të cilën ekspertizë janë përshkruar edhe dhimbjet fizike si dhe intensiteti i tyre, e pastaj është dhënë mendimi edhe për shëmtimin trupor, shkallën e të njëjtit si dhe frikën ku theksohet se nuk ekziston frika primare, ndërsa është manifestuar frika sekondare dhe ate intensitetit të lartë dhe të ulët, ku eksperti ka përshkruar kohëzgjatjen e këtyre intensiteteve lidhur me frikën.

Gjykata e shkallës së parë në pjesën arsyetuese të aktgjykimit i ka arsyetuar të gjitha bazat e kërkuara të këtij dëmi material dhe jo material, e këtë bazuar në provat e administruara, ekspertizat përkatëse mjekësore dhe ekspertizën teknike të makinerisë, si dhe ka dhënë arsyetimin adekuat në të njëjtat, ndërkaq, në anën tjetër e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit përtej shumave të gjykuara duke vendosur si në paragrafin III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

Këtë gjendje faktike të çështjes gjykata e shkallës së parë e ka bazua në dispozitat ligjore të nenit 154, 178, 200 dhe 277 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 452 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m ) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyre të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Thëniet ankimore të paditurës lidhur me atë se, aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, është pretendim i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm, për faktin se gjykata e shkallës së parë pasi që ka vërtetuar gjendjen faktike të bazuar në prova konkrete materiale dhe ekspertime përkatëse të caktuara për këtë çështje, ka marr aktgjykimin e atakuar me të cilin me të drejtë, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Gjithashtu, në këtë gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, siç pa të drejtë pretendon e paditura, sepse vendimin e saj e ka mbështetur në dispozita konkrete ligjore të LMD-së dhe LPK-së, që i referohen kësaj çështje juridike konkrete.

Në këtë drejtim, është i pa qëndrueshëm edhe pretendimi ankimor i të paditurës, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, edhe pse në ankesën e paraqitur askund nuk janë theksuar konkretisht se cilat dispozita janë shkelur, megjithatë, Gjykata e Apelit aktgjykimin e atakua e vlerësoi edhe në këtë aspekt dhe konkludoi se, aktgjykimi i tillë nuk është përfshirë me shkelje të tilla për të cilat pa të drejtë pretendon e paditura, e as me shkelje të tjera për të cilat siç u tha edhe më sipër Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare konform të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar. Në këtë aspekt është i pa bazuar edhe pretendimi ankimor për një kompensim tepër të lartë për paditësin, duke konsideruar si tejkalim i qëllimit në kuptim të nenit 200 të LMD-së, sepse sipas Gjykatës së Apelit në situata të tilla të ngjashme me këtë të paditësit të gjitha gjykatat në Kosovë afërsisht caktojnë shumën të njëjta, ku janë në pyetje lëndime të lehta trupore si në rastin konkret.

Gjykata e Apelit e vlerësoi edhe pretendimin ankimor të paditurës për dëmin material, por se një pretendim të tillë e refuzoi si të pa bazuar, meqë gjykata e shkallës së parë këtë lloj të dëmit material e ka vërtetuar me ekspertizën përkatëse të makinerisë, të cilin e ka punuar eksperti Gani Musliu me datën 18.07.2016, ku është vlerësuar se vlera e dëmit të shkaktuar në automjetin e paditësit është në shumë prej 831.00 €, të cilin konkludim si të drejtë dhe real e konsideron edhe Gjykata e Apelit.

Prandaj, aktgjykimi i atakuar është i qartë dhe i përshtatshëm për përmbarrim, ndërsa pretendimet e të paditurës për dispozitiv të mangët të paqartë dhe kontradiktor me arsyetimin e dhënë janë të pa baza, dhe si të tilla u refuzuan nga Gjykata e Apelit.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka vlerësuar dhe gjykuar, kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, për dëmin e shkaktuar paditësit, nga veprimet e të siguruarit të paditurës dhe lidhur me këtë në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar nga gjykata e shkallës së parë janë dhënë arsye të mjaftueshme si dhe faktet vendimtare të cilat e kanë shtyrë gjykatën për një vendosje të tillë. Pra, baza e kërkesëpadisë drejtë është vërtetuar nga ana e gjykatës e po ashtu, edhe lartësia e kërkesëpadisë bazuar në ekspertizën përkatëse të ekspertit të makinerisë drejtë është gjykuar.

Sipas Gjykatës së Apelit është i pa bazuar pretendimi ankimor lidhur me shpenzimet e procedurës të cilat i ka caktuar gjykata e shkallës së parë, në rastin konkret si në paragrafin II të dispozitivit dhe atë në shumën prej 924,00 €, sepse lidhur me këto shpenzime gjykata ka gjetur mbështetje në dispozitën ligjore të nenit 452 paragrafi 1 ku në pjesën arsyetuese janë specifikuar veç e veç secili shpenzim, i cili është krijuar nga ana e paditësit. Kështu që edhe përkundër faktit se kërkesëpadia e paditësit është miratuar pjesërisht, megjithatë Gjykata e Apelit vlerëson se, paditësi që nga përpilimi i padisë lidhur me këtë çështje juridike kontestimore ka paguar shpenzimet e avokatit në shumën të plota, pastaj pjesëmarrjen e tij në seanca gjyqësore, ekspertizat përkatëse dhe shpenzimet tjera gjyqësore për të cilat paditësi nuk ka mundur që të di në fillim se sa do të jenë ato, kështu që pavarësisht dispozitës së nenit 452 të LPK-së, gjykata nuk mund t'ia mohoj paditësit shpenzimet e bëra të cilat kryesisht janë bërë për shkak të neglizhencës së të paditurës, e cila nuk e ka zgjidhur këtë çështje në procedurë jashtë gjyqësore.

Në rastin konkret të gjitha konstatimet nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit i vlerëson si të drejta dhe të ligjshme dhe qëndrimin juridik të saj e akcepton në tërësi.

Meqë, e paditura nuk e ka atakuar paragrafin III të dispozitivit, me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit mbi shumat e gjykuara, atëherë këtë pjesë Gjykata e Apelit nuk e shqyrtoi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) dhe nenin 200 LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 4902/2016 më dt. 25.07.2018

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI

*Gëzim Llulluni*